

Zyrtarët e PDK-së vizitojnë
liderët e UÇK-së në Hagë:
Maskat do të bien, luftëtarët
do të kthehen fitimtarë I FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

OPOZITA NË KOSOVË MBËSHKET DIALOGUN DHE PROPOZIMIN EVROPIAN,
POR ME DISA KUSHTE I FAQE 4-5

PA NJOHJEN E KOSOVËS, PROPOZIMI I BE-së, I PAPRANUESHËM PËR OPOZITËN



Opozita në Kosovë është duke i dhënë mbështetje procesit të dialogut me Serbinë. Pavarësisht kësaj, përfaqësuesit e PDK-së, të LDK-së dhe të AAK-së kanë thënë se propozimi i BE-së për normalizimin e

marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë është i papranueshëm nëse në të nuk përfshihet njohja reciproke. Ndërsa njohësi i proceseve politike, Agon Maliki, ka thënë se qëndrimi i opozitës mund të

jetë taktikë në mënyrë që në rast se në fund të negociatave nuk do të ketë njohje të drejtpërdrejtë të Kosovës nga ana e Serbisë, atëherë kjo, sipas tij, do të prezantohet si dështim i qeverisë Kurti

KRASNIQI,
KURTIT: PSE PO
E MBRONI ME
KAQ BESNIKËRI
MARTIN
BERISHAJN? I FAQE 3



KURTI: NUK JAM FTUAR
NË TAKIMIN E AMBASADËS SË
SHBA-SË PËR ASOCIACIONIN
I FAQE 3

AKTUALE



ABDIXHIKU: GJENDJA
NË SHËNDETËSI ËSHTË E
PAPRANUESHME F. 7

TAHIRI: QEVERIA KURTI PO
TREGOHET E DOBËT NË NEGOCIATA F. 4

RAMA: MË AKUZOJNË ATA QË
KANË MBI KURRIZ GËRDECIN,
21 JANARIN DHE QË VOTONIN
KUNDËR UÇK-së F. 3

PRESIDENTJA OSMANI KUJTON
VIKTIMAT HEBREJE NË DITËN E
HOLOKAUSTIT F. 7

"BLOOMBERG": NJË TJETËR PIKË
E NXEHTË EVROPIANE KËRCËNON
TË SHPËRTHEJË F. 5

EKONOMI



MURATI PËR RRIJTJEN E FATURAVE
TË TATIMIT NË PRONË FAJËSON
ISH-QEVERITË E KALUARA F. 8

ATK-ja KRIJON MUNDËSINË E
PAGESËS TË TATIMIT ME KËSTE F. 8

SPORT



KUVENDI MIRATON STATUTIN
E RI TË FFK-së F. 10

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjiibiznesi.com
info@kolegjiibiznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Scholz kujton përgjegjësinë e Gjermanisë për Holokaustin

BERLIN, 27 JANAR - Kancelari gjerman Olaf Scholz ka përmendur përgjegjësinë historike të Gjermanisë për vrasjen e miliona hebrenjve në periudhën e nazizmit teksa ky shtet përkujton viktimat. “Vuajtjet e 6 milionë hebrenjve të vrarë pafajësisht janë të paharruara ashtu sikurse vuajtjet e të mbijetuarve”, ka

shkruar Scholz në “Twitter”. Në kuadër të përkujtimit të viktimave në Gjermani, e mbijetuar e Holokaustit, Rozette Kats, pritet të flasë para Parlamentit gjerman. Presidentja e Parlamentit gjerman, Barbel Bas, do ta hapë takimin e veçantë, në të cilin pritet të marrë pjesë edhe presidenti gjerman Frank-

Walter Steinmeier. Ceremonia përkujtimore e këtij viti fokusohet në njerëzit që janë persekutuar nga nazistët për shkak të orientimit të tyre seksual apo identitetit. Më 27 janar 1945 ushtarët e Ushtrisë së Kuqe kanë çliruar të mbijetuarit e kampit të koncentritimit Aushvic në Poloni. Nazistët kanë vrarë më shumë se 1 milion

njerëz atje, kryesisht hebrenj. Përveç vrasjeve në këtë kamp, gjenocidi i kryer kundër hebrenjve gjatë Luftës së Dytë Botërore, i njohur si Holokaust, ka rezultuar me vrasjen sistematike të rreth 6 milionë hebrenjve. Kjo datë, 27 janari, shënohet në Gjermani si Dita e Përkujtimit të Holokaustit, prej vitit 1996.



Polonia do t’ia dërgojë Ukrainës 60 tanke të modernizuara



VARSHAVË, 27 JANAR - Kryeministri polak Mateusz Morawiecki ka thënë se Polonia do të dërgojë dhjetëra tanke në Ukrainë këtë vit. Në një intervistë për televizionin kanadez “CTV”, ai ka thënë se shteti i tij do të dërgojë 60 tanke të avancuara, përveç 14 tankeve të modelit gjerman “Leopard 2”. Varshava, e cila e ka pozicionuar veten si një prej vendeve më mbështetëse ndaj Ukrainës, i ka

bërë presion të konsiderueshëm Gjermanisë në javët e fundit që ta mundësojë dërgimin e tankeve “Leopard 2” në Kiev. Gjermania është pajtuar për të dërguar vetë këto tanke në Ukrainë, por edhe u ka dhënë dritën e gjelbër shteteve të tjera që të veprojnë njëjtë. “Tani për tani, ne jemi të gatshëm të dërgojmë 60 tanke tona të modernizuara, 30 prej tyre PT-91. Përveç tyre janë

edhe 14 tanke Leopard 2, që i kemi në dispozicion”, ka thënë kryeministri polak. “PT-91” është tanke luftarake polake e cila ka nisur të përdoret për herë të parë në vitet 1990. Presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky e ka falënderuar Poloninë për dërgimin e më shumë tankeve. “Së bashku ne do të fitojmë”, ka shkruar ai në një postim në “Twitter”. Lufta në

Ukrainë ka nisur më 24 shkurt 2022. Presidenti rus Vladimir Putin e quan luftën “operacion special ushtarak” për ta çmilitarizuar Ukrainën. Perëndimi është përgjigjur ndaj Ruisë, duke goditur ekonominë e këtij shteti me sanksione të ashpra. Si pasojë e luftës kanë vdekur mijëra persona dhe miliona të tjerë janë zhvendosur nga shtëpitë e tyre.

Rusia po e drejton fokusin e luftës kah “NATO-ja dhe Perëndimi”

TOKIO, 27 JANAR - Sekretari i Përgjithshëm i Bashkimit Evropian për Veprim të Jashtëm, Stefano Sannino, ka thënë të premten se Rusia e ka çuar luftën e saj në Ukrainë “në një nivel tjetër”, duke kryer sulme ndaj civilëve dhe shënjestrave joushtarake. Ai e ka kritikuar Moskën për nxitje të vendimeve që kanë marrë Shtetet e Bashkuara dhe Gjermania për të dërguar tanke të avancuara në Ukrainë. Duke folur në një konferencë në Tokio, Sannino ka thënë se Putini “ka lëvizur nga koncepti i operacionit special në

konceptin e luftës kundër NATO-s dhe Perëndimit”. Ai ka thënë se tanket gjermane dhe amerikane pritët t’u ndihmojnë ukrainasve që ta mbrojnë veten në luftë dhe nuk do t’i kthejnë ata në sulmues. “Mendoj se zhvillimet e fundit, sa iu përket furnizimeve me armë, janë përgjigje ndaj situatës dhe mënyrës se si Rusia e ka çuar luftën në nivel tjetër”, ka thënë Sannino. Shtetet e Bashkuara dhe Gjermania kanë bërë me dije të mërkurën se do të dërgojnë tanke të avancuara në Ukrainë për t’i ndihmuar Kievit që t’i

luftojë forcat ruse. Komandantët e ushtrisë ukrainase kanë thënë se këto armë do të ndihmojnë në kundëroffensiva dhe do ta zvogëlojnë numrin e ushtarëve ukrainas të vrarë në luftë. Presidenti amerikan Joe Biden ka thënë se shteti i tij do të dërgojë 31 tanke “M1 Abrams” pavarësisht prej qëndrimeve fillestare të Uashingtonit se ato janë shumë sfiduese që të përdoren nga ushtarët ukrainas. ShBA-ja e ka bërë me dije këtë vendim pasi Gjermania është pajtuar për të dërguar 14 tanke



“Leopard 2” nga inventari i saj. Rusia e ka kritikuar vendimin e shteteve perëndimore dhe

është zotuar se do t’i shkatërrojë këto tanke në fushëbetejë.

Pas tankeve, Zelensky kërkon avionë luftarakë, ShBA-ja dhe Franca: Jemi gati!

KIEV, 27 JANAR - Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) janë të hapura ndaj mundësisë për të dërguar avionë luftarakë në Ukrainë sipas një deklarate të zëvendëskëshilltarit të sigurisë kombëtare të Joe Biden, John Feiner. I pyetur nëse ShBA-ja po shqyrtonte dërgimin e avionëve luftarakë për në Ukrainë, siç ka kërkuar presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky, Feiner ka thënë se Uashingtoni nuk kishte përjashtuar ndonjë sistem specifik të armëve dhe se forma e mbështetjes së ShBA-së do të vlerësohej bazuar në nevojat e saj. “Ne do ta diskutojmë me



shumë kujdes”, ka thënë ai, duke iu referuar kërkesave të Kievit. Edhe kryeministri polak

Mateusz Morawiecki ka thënë se do të mbështeste një vendim të NATO-s për të dërguar avionë luftarakë në Kiev, sipas zëvendësministrit të Jashtëm të Ukrainës, Andrii Melnyk, i cili u ka bërë thirrje aleatëve perëndimorë që t’i japin vendit të tij avionë luftarakë modernë për t’u mbrojtur kundër luftës ofensive të Ruisë. “Ne do të duhet t’i shqyrtojmë kërkesat rast pas rasti dhe t’i lëmë të gjitha dyert të hapura”, ka thënë kryetari i Komitetit të Mbrojtjes të Asamblesë Kombëtare Franceze, Thomas Gasillou, duk shtuar se vendet e Evropës Lindore janë duke e shqyrtuar

një mundësi të tillë. “Do të shohim se çfarë do të ndodhë në javët e ardhshme sepse gjërat po ecin me shpejtësi. Danezët dhe vendet e Evropës Lindore janë duke shqyrtuar një mundësi të tillë”, ka thënë ai pas bisedimeve me homologun e tij britanik, Tobias Ellwood dhe sekretarin e mbrojtjes të Mbretërisë së Bashkuar, Ben Wallace. Sipas medieve britanike, Gasillou ka deklaruar se dërgimi i avionëve luftarakë në Ukrainë nuk duhet të rrezikojë sigurinë e Francës dhe Evropës dhe nuk duhet të përshkallëzojë luftën e Ruisë.

Zyrtarët e PDK-së vizitojnë liderët e UÇK-së në Hagë: Maskat do të bien, luftëtarët do të kthehen fitimtarë

HAGË, 27 JANAR (ER) - Nënkryetarja e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Vlora Çitaku, ka njoftuar se me një pjesë të kolegëve të saj kanë vizituar në Hagë, Hashim Thaçin, Kadri Veselin dhe Rexhep Selimin. Ajo ka thënë se beteja e liderëve të UÇK-së në Hagë është për të kaluarën dhe të ardhmen e kombit. Në këtë kontekst, ajo ka thënë se maskat do të

bien dhe liderët e UÇK-së do të kthehen fitimtarë. “Sot bashkë me Bekimin (Çollaku), Artanin (Behrami) e Arlindën (Ramadani) e vizituam presidentin Thaçi. Shkurt takuam edhe Kadriun dhe Rexhën. Si gjithmonë, i gjetëm me disponim të mirë. Plot besim në drejtësi. Beteja të cilën baca Jakup, Thaçi, Veseli e Selimi e kanë para vetes është betejë për të

kaluarën dhe të ardhmen tonë si komb. Por nuk ka dilemë se maskat do të bien dhe luftëtarët tanë do të kthehen fitimtarë. Vetëm njerëzit e jashtëzakonshëm ballafaqohen me sfida të jashtëzakonshme. Procesi gjyqësor pritet të fillojë së shpejti. Besojmë që e vërteta dhe drejtësia do të ngadhënjëjnë përpallë shpifjeve dhe inskenimeve”, ka shkruar Çitaku.



Krasniqi, Kurtit: Pse po e mbroni me kaq besnikëri Martin Berishajn?

PRISHTINË, 27 JANAR - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, ka publikuar të premten një video-selfie në “Facebook” përmes së cilës i është drejtuar kryeministrit Albin Kurti me një varg pyetjesh se pse nuk po shkarkohet ambasadori i Kosovës në Kroaci, Martin Berishaj, pas shpërthimit të skandalit financiar dhe lidhjes së tij me mafian energjetike serbe. Krasniqi ka theksuar se mbi dy milionë euro që janë i dhënë mikut të Albin Kurtit dhe Lëvizjes Vetëvendosje, Martin Berishaj nga një kompani energjetike sllovene, me degë në Serbi, nuk dihet se ku kanë përfunduar. “Kjo

aferë e Martin Berishajt, e raportuar në medie ndërkombëtare, ngre dyshime serioze për Qeverinë e Kosovës. Si mund të flitet për respektimin e shtetit të së drejtës, ndërkohë që përfaqësuesit më të lartë të shtetit tonë përshihen në afëra të tilla financiare dhe ata mbrohen nga krerët e shtetit? Si ndikon ky skandal në imazhin e shtetit tonë, tani kur jemi në prag të liberalizimit të vizave dhe kur kemi aplikuar për anëtarësim në Bashkimin Evropian?”, ka thënë Krasniqi. Më tutje, Krasniqi ka konsideruar se qytetarët me të drejtë po pyesin dhe meritojnë të dinë se si është



bërë që Berishaj për një ditë e ka marrë nënshtrësinë e Kosovës dhe të nesërmen është emëruar ambasador në Kroaci. Po ashtu, ai ka thënë se qytetarët janë duke

pyetur se si e ka kaluar Berishaj verifikimin e sigurisë nga institucionet përgjegjëse të vendit dhe si është e mundur që qeveria po e mbron Berishajn me kaq

besnikëri. “Dhe më e rëndësishmja: Kryeministër, pse po heshtë për këtë skandal dhe pse po e mbron kaq shumë bashkëpunëtorin tënd të ngushtë, ambasadorin Martin Berishaj? Ju keni premtuar se do ta luftoni korrupsionin, e tash ndodheni në mesin e një skandali rajonal të korrupsionit. Po vepron si një struc kryeministër, duke e zhytur kokën në rërë dhe duke pritur që ky problem disi do të kalojë. Por, këtë herë nuk do t’ia dalësh duke heshtur. Qytetarët po e kërkojnë të vërtetën dhe ata meritojnë ta dinë tregimin e plotë për aferën Martin Berishaj”, ka deklaruar Krasniqi.

Kurti: Nuk jam ftuar në takimin e Ambasadës së ShBA-së për asociacionin



PRISHTINË, 27 JANAR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka bërë me dije se nuk është ftuar në një takim që do ta organizojë Ambasada e ShBA-së në Prishtinë më 31 janar, e ku do të diskutohet për krijimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë. Në një intervistë për “Radion Evropa e Lirë”, Kurti ka thënë se ky takim do të zhvillohet si pasojë e insistimit të të dërguarit të Shteteve të

Bashkuara të Amerikës për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar. Ai ka thënë se ka pritur nga Escobari që të thotë në Beograd se Serbia duhet ta njohë Kosovën e jo të thotë në Prishtinë se Asociacioni do të bëhet pavarësisht kryeministrit të Kosovës. “Unë nuk jam ftuar në atë takim, por ata që janë ftuar le të shkojnë në atë takim dhe le ta diskutojnë. Por, po ritheksoj, nga 33

marrëveshjet e Brukselit nuk bën të zgjidhet njëra sepse nuk ka hierarki. Nuk mund të krijohen hierarki artificiale përveç rendit kronologjik. Ndërkaq, në anën tjetër, edhe nga propozimi i Bashkimit Evropian nuk mund të përzgjidhet vetëm ndonjë nen i cili mendohet që e përfshin Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe. Pra, unë besoj se ky takim është pasojë e insistimit të zyrtarit të Departamentit të

Shtetit amerikan, i cili është edhe emisar special për Ballkanin dhe i cili ka deklaruar që, pavarësisht kryeministrit të Kosovës, Asociacioni duhet të bëhet”, ka thënë Kurti. Duke folur për planin evropian për normalizimin e marrëdhënieve Kosovë - Serbi, Kurti tha se ai nuk i është prezantuar në formën “merre ose lëre”, por si platformë për diskutim të mëtutjeshëm.

Rama: Më akuzojnë ata që kanë mbi kurriz Gërdecin, 21 janarin dhe që votonin kundër UÇK-së

TIRANË, 27 JANAR - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka reaguar prapë pas akuzave për lidhjet e tij me ish-zyrtarin e FBI-së, Charles McGonigal. “Ky mal i madh mbarsur me fantazi dhe ligësi do të pjellë edhe më pak se një mi. Fatmirësisht, gjithçka është e hetuar në ShBA dhe konkluzioni i hetimit s’ka asnjë lidhje me mua a me qeverinë shqiptare. Paratë e marra prej rusëve nga PD-ja nuk janë shpikje, po fakte, po ashtu i hetuar dhe i provuar botërisht. Deri dje thoshin Edi Rama dhe Soros, sot thonë Edi Rama dhe

zyrtari i lartë i FBI-së, por si njëra si tjetra bien përtokë përballë fakteve të hetuara”, ka thënë Rama. Në këtë çështje, sipas kryeministrit Rama, zyrtari i lartë i FBI-së nuk akuzohet fare për asgjë nga këto që fliten me ulërima në Shqipëri, por vetëm për konflikt interesi në marrjen e borxhit nga miku i vet shqiptaro-amerikan dhe mosdeklarim të tij. Kompania “Strabag” është flamuri më i madh i ekonomisë austriake, e cila ashtu si edhe kompania “Trema”, operojnë në Shqipëri prej

dekadash, shkruan gazeta “Tema”. “Dihet që njerëz të dëshpëruar bëjnë gjëra të dëshpëruara dhe kjo histori është pasqyrë besnike e dëshpërimit të opozitës sonë, e cila, përveçse s’ka kokë, ka mbi kurriz çështje madhore si Gërdeci, 21 janari apo edhe lidhjet ruse qysh në kohën kur bashkoi votën me partinë e Putinit në Këshillin e Evropës kundër Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Të gjitha këto janë fakte që kërkojnë drejtësi, jo teori konspiracioni dhe s’ka teori konspiracioni që i varros dot në harresë”, deklaroi Rama.





OPOZITA NË KOSOVË MBËSHTETET DIALOGUN DHE PROPOZIMIN EVROPIAN, POR ME DISA KUSHTE

Pa njohjen e Kosovës, propozimi i BE-së, i papranueshëm për opozitën

Opozita në Kosovë është duke i dhënë mbështetje procesit të dialogut me Serbinë. Pavarësisht kësaj, përfaqësuesit e PDK-së, të LDK-së dhe të AAK-së kanë thënë se propozimi i BE-së për normalizimin e marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë është i papranueshëm nëse në të nuk përfshihet njohja reciproke. Ndërsa njohësi i proceseve politike, Agon Maliqi, ka thënë se qëndrimi i opozitës mund të jetë taktikë në mënyrë që në rast se në fund të negociatave nuk do të ketë njohje të drejtpërdrejtë të Kosovës nga ana e Serbisë, atëherë kjo, sipas tij, do të prezantohet si dështim i qeverisë Kurti

PRISHTINË, 27 JANAR - Partitë politike opozitare në Kosovë mbështetnin procesin e dialogut me Serbinë, por ato kanë thënë se nuk pajtohen me propozimin e Bashkimit Evropian (BE) për normalizimin e marrëdhënieve në rast se nga ky propozim nuk rrjedh njohja e Kosovës nga ana e Serbisë. Qëndrimi i partive opozitare është i ngjashëm me atë të Qeverisë së Kosovës. Njohësi i proceseve politike, Agon Maliqi, ka vlerësuar se deklaratat e qeverisë dhe të partive opozitare janë taktike dhe synojnë forcimin e pozicionit të Kosovës në negociatë, por janë edhe për politikë të brendshme.

Propozimi i BE-së për normalizimin e marrëdhënieve Kosovë - Serbi u është dorëzuar dy vendeve në fund të verës së vitit të kaluar, por përmbajtja e tij nuk është bërë publike. Ky propozim, në të cilin ka pasur qasje "Radio Evropa e Lirë", parashihet të drejtë të barabarta për Kosovën dhe Serbinë, respektim të integritetit territorial, paprekshmëri të kufijve, njohje të simboleve shtetërore dhe një aranzhim të veçantë për komunitetin serb në Kosovë. Në dokument nuk përmendet njohja e ndërsjellë ndërmjet Kosovës dhe Serbisë apo

anëtarësimi i Kosovës në Organizatën e Kombeve të Bashkuara – për të cilat gjëra insistojnë publikisht zyrtarët kosovarë – por theksohet mbështetja që palët duhet t'i japin njëra-tjetrës në procesin e integritimeve evropiane. Propozimi i Bashkimit Evropian, që më herët njihej si plani franko-gjerman, ka marrë mbështetjen edhe të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Partia Demokratike e Kosovës (PDK) e ka mirëpritur propozimin e Bashkimit Evropian për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, por vetëm si bazë për bisedime për marrëveshjen përfundimtare ndërmjet dy shteteve, thotë deputeti i kësaj partie, Rashit Qalaj. Megjithatë, siç thekson ai, qëndrimi i PDK-së është që propozimi, i cili duhet të diskutohet për një marrëveshje përfundimtare, duhet t'i përmbajë pesë elemente të domosdoshme: ruajtjen e karakterit unitar të vendit, njohjen nga pesë shtetet e BE-së që nuk e kanë njohur deri më tash Kosovën, integrimin në strukturat e NATO-s apo në Partneritetin për

paqe, marrjen e statusit kandidat për Bashkimin Evropian, si dhe njohjen e ndërsjellë ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. "Mendoj se propozimi nuk është marrëveshje për të cilën Kosova ka pritur për një kohë të gjatë. Marrëveshja që nuk e ka në përbërjen e saj njohjen e ndërsjellë ndërmjet Kosovës dhe Serbisë është marrëveshje që nuk sjell stabilitet në Ballkan dhe vetëm e shtyn zgjidhjen e problemit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë", ka thënë Qalaj. Sipas tij, propozimi i BE-së për normalizimin e marrëdhënieve duhet të negociohet. "Meqenëse e dimë se propozimi, si i tillë, nuk është final, por është bazë e mirë për bisedime, qëndrimi ynë është se marrëveshja gjithsesi duhet t'i ketë të pesë elementet që i përmendëm", ka thënë Qalaj. Nën kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lutfi Haziri, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se qëndrimi i partisë së tij është se një marrëveshje ndërmjet Kosovës dhe Serbisë është e domosdoshme dhe se duhet të arrihet sa më shpejt. Por, siç ka thënë ai, një marrëveshje e tillë duhet të ketë për efekt njohjen.

Mirëpo, me aq sa dihet deri më tash, njohja e Kosovës nga Serbia nuk figuron në tekstin e propozimit të Bashkimit Evropian për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet dy vendeve e cila u është dorëzuar qeverive të dy shteteve. Siç ka thënë Haziri, dialogu që nuk do të përfundojë me njohjen e Kosovës nga ana e Serbisë, "nuk do të ketë kurrfarë kuptimi". "Asnjë marrëveshje, e cila nuk e ka njohjen si përfundim, nuk do të jetë e mjaftueshme dhe nuk do të jetë e mbështetur nga LDK-ja. Ky është qëndrimi ynë i rikonfirmuar tash, në 10 ditët e fundit, përkundër që ne kemi mbështetur dialogun dhe e mbështesim qeverinë si mandatarë kushtetuese", ka thënë Haziri. Ai ka thënë se këtë qëndrim politik do ta konfirmojnë edhe në takimet që Ambasada e ShBA-së në Prishtinë pritet të organizojë me partitë politike dhe shoqërinë civile që nga 31 janari. "Askush nuk ka pritur, asnjëherë, që në dokumente bazë të palëve të jetë e shkruar ose e pritur në mënyrë eksplicite pavarësia e Kosovës, sepse Serbia do të vazhdojë të kundërshtojë nga ana e saj çdo lloj pranimi të Kosovës dhe do të mundohet ta

Tahiri: Qeveria Kurti po tregohet e dobët në negociatë

PRISHTINË, 27 JANAR - Ish-kryenegociatorja e Kosovës, Edita Tahiri, ka reaguar lidhur me modifikimet që i janë bërë propozimit franko-

gjerman për një marrëveshje në mes të Kosovës dhe Serbisë. Tahiri ka thënë se atij plani çdo ditë po i shtohet nga një pikë, por jo edhe ajo

për njohjen reciproke. Sipas saj, kjo gjë tregon dobësinë e Qeverisë së Kosovës. "Planit franko-gjerman çdo ditë po i shtohet nga një pikë, por nuk

iu shtua pika e njohjes reciproke. Kjo tregon dobësinë e Qeverisë së Kosovës", ka shkruar Tahiri në "Facebook".



“Bloomberg”: Një tjetër pikë e nxehtë evropiane kërcënon të shpërthejë

NJU-JORK, 27 JANAR - Ndërkohë që bota është e fokusuar në pushtimin rus të Ukrainës, tensionet në rritje po kërcënojnë ta ndezin një tjetër konflikt në Ballkanin Perëndimor, shkruan mediumi amerikan “Bloomberg”.

Acarimi i marrëdhënieve midis Serbisë dhe Kosovës është përshkallëzuar në një nga nivelet më ekstreme që nga përfundimi i luftimeve në Ballkan në vitin 1999.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, po e riafirmon të drejtën e vendit të tij për sovranitet duke kërkuar që serbët që kanë mbetur në shtetin kryesisht etnik-shqiptar pas shpalljes së pavarësisë t'u përmbahen ligjeve

të tij.

Serbia dhe aleatet e saj, Rusia dhe Kina, refuzojnë ta njohin Kosovën në skenën botërore, duke i bllokuar të dyja nga synimi i tyre për t'u bashkuar me BE-në. Shtytja e Kurtit, në një kohë kur BE, NATO dhe Rusia janë të preokupuara me luftën në Ukrainë, po e prish ngërçin tejet delikat. Serbët kosovarë reagues ndaj një vendimi të qeverisë në Prishtinë duke kërkuar që t'i ndërrojnë kartat e identitetit dhe targat e tyre duke ngritur barrikada pranë kufirit, një jehonë e protestave që i paraprinë fillimit të luftës Serbi - Kroaci në vitet 1990.

Në anën tjetër është presidenti serb Aleksandër Vuçiq, i cili është

përballur me akuzat e së kaluarës për nxitje të tensioneve etnike. Mirëpo muajin e kaluar ai i bindi serbët e tij që t'i zhbllokojnë bllokadat e rrugëve në pjesën veriore të Kosovës.

Nën presionin e të dërguarve të ShBA-së dhe Evropës, Vuçiqi ka ndërmarrë një hap tjetër këtë javë, duke thënë se vendi i tij duhet ta shqyrtojë një propozim të BE-së për t'i normalizuar lidhjet me Kosovën. Kjo qasje mund ta sigurojë një mënyrë për të zgjidhur një nga problemet më të vështira gjeopolitike të Evropës dhe për ta liruar rajonin në fjalë që të integrohet përfundimisht në BE. Mirëpo Kurti dhe Vuçiqi përballen me kundërshtime për të mos bërë koncesione dhe secili



prej tyre ka vija të kuqe të cilat tjetri i ka hedhur poshtë. Ndërkohë që një kompromis mund të jetë ende i mundur, javët dhe muajt e ardhshëm mund të

jenë dëshmitarë ku palët do t'i thellojnë edhe më shumë mospajtimet e tyre përtej të cilave nuk mund ta bëjnë asnjë koncesion.

KDI-ja: Qeveria ta tregojë qëndrimin për propozimin franko-gjerman dhe asociacionin

PRISHTINË, 27 JANAR (ER) - Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka vlerësuar se vizitat e shpeshta të emisarëve specialë nga Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian janë duke dëshmuar për një dinamikë të shtuar në dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë. Në këtë kontekst, KDI-ja ka theksuar se përderisa procesi gjendet në një fazë mjaft delikate, qytetarët e Kosovës janë të painformuar mbi përmbajtjen e takimeve të ndërlidhura me dialogun dhe dakordimet eventuale lidhur me këtë proces. Sipas KDI-së, diskutimet mbi përmbajtjen e propozimit franko-gjerman/evropian dhe zbatimin e marrëveshjes së dialogut mbi asociacionin janë temat kryesore në debatet mediale, ndërkohë që mungon



një debat i strukturuar politik e shoqëror dhe një mostransparencë e theksuar e

qeverisë mbi qëndrimet e saj në raport me këto propozime. Më tutje, KDI-ja ka kërkuar nga

Qeveria e Kosovës ta tregojë qëndrimin e saj për propozimin evropian dhe Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe. “Duke qenë i mbyllur dhe i reduktuar, ky proces çdo ditë e më tepër po krijon hapësirë për dezinformim, pasiguri dhe ulje të besimit të publikut. Informacionet selektive dhe deklaratat e kufizuara të emisarëve ndërkombëtarë mbeten burimet e vetme të informacioneve, ndërkohë që qeveria po shmang adresimet për publikun. Prandaj qeveria si mandatare për ta udhëhequr dialogun me Serbinë duhet të jetë e hapur dhe ta informojë publikun lidhur me qëndrimet e saj dhe të priturat nga ky proces. Kjo duhet t'i përfshijë edhe raportimet me vetiniciativë të

kryeministrit në Kuvendin e Kosovës si institucioni më i lartë përfaqësues. Meqë përmbyllja e dialogut Kosovë - Serbi është çështje e interesit nacional, pritjet tona janë që edhe subjektet politike opozitare të tregohen të përgjegjshme dhe serioze në përpjekjet e tyre për ta mbajtur qeverinë llogaridhënëse dhe për t'i ofruar kapacitetet e tyre në formësimin e qëndrimeve sa më konsensuale të palës kosovare. Në këtë drejtim, opozita përmes praktikave dhe instrumenteve kushtetuese parlamentare do të duhej ta ftonte kryeministrin në raportim në një seancë të jashtëzakonshme të Kuvendit në lidhje me zhvillimet në procesin e dialogut”, është thënë në reagimin e KDI-së.

gjejë një derë që të ikë dhe të blejë kohë sërish me mosnjohje. Por, ne duhet t'i bindim dhe duhet të argumentojmë para ndërmjetësve ndërkombëtarë, para faktorit ndërkombëtar, në veçanti zotit (përfaqësuesi i lartë i Bashkimit Evropian, Josep) Borrell dhe qeverisë amerikane, se njohja është zgjidhja e problemeve, ndërkëq me mosnjohjen e pavarësisë (së Kosovës nga Serbia), Kosova mbetet problem i hapur në mes Serbisë dhe saj”, ka thënë Haziri.

“Radio Evropa e Lirë” ka bërë përpjekje për të kontaktuar me zyrtarët e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), por ata nuk ishin të qasshëm. Megjithatë, në dhjetor të vitit të kaluar, lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj, kishte shprehur mendimin se propozimi i BE-së, ofron një bazë të pranueshme për bisedime të mëtejshme me Serbinë dhe se me këtë propozim “marrëdhëniet ndërmjet Kosovës dhe Serbisë rregullohen në bazë të

kapitujve të Kartës së OKB-së për marrëdhëniet mes shteteve”. “Unë besoj se baza është e qëndrueshme dhe kjo marrëveshje (propozim) është e qëndrueshme, dhe [në fund] e zgjidh çështjen e mbetur pezull - pra të njohjes së ndërsjellë Kosovë - Serbi. Nuk shoh se do të duhet prapë në të ardhmen të bisedohet për njohjen e ndërsjellë për shkak se (ky propozim) e zgjidh njëjën e marrëdhënieve Kosovë - Serbi”, ka thënë Haradinaj. Njohësi i proceseve politike, Agon Maliqi, ka vlerësuar se deklaratat – qoftë të kryeministrit Kurti, por edhe të partive opozitare – lidhur me propozimin e BE-së për normalizimin e marrëdhënieve Kosovë - Serbi, mund të kenë natyrë taktike.

Në këtë mënyrë, sipas tij, Qeveria e Kosovës dërgon sinjalin se pozicioni i saj në negociata është arritja e njohjes nga Serbia dhe se nga ky synim nuk mund të heqë dorë. Ndërkëq, deklaratat e opozitës, siç thotë Maliqi, mund të jenë taktike dhe për politikën e

brendshme, në mënyrë që në rast se në fund të negociatave nuk do të ketë njohje të drejtpërdrejtë të Kosovës nga ana e Serbisë, atëherë kjo të prezantohet si dështim i qeverisë. “Kosova e kërkon njohjen reciproke, jo detyrimisht se ka qejf që ta njohë Serbia, por për shkak se mungesa e kësaj njohjeje nga Serbia po shkakton probleme. Një prej këtyre problemeve është çështja e njohjes nga (pesë) vendet e BE-së apo anëtarësimi në organizata ndërkombëtare. Në qoftë se marrëveshja, përmes njohjes së tërthortë, e arrin këtë rezultat – pra, të ketë garanci që Kosova futet në organizata ndërkombëtare, përjashtoj mbase OKB-në – apo e siguron njohjen prej pesë shteteve të BE-së, atëherë mendoj që edhe Kosova do të mund ta shohë të dobishme marrëveshjen”, ka thënë Maliqi.

Ai ka thënë se deklaratat dhe qëndrimet, pothuajse të ngjashme, të pushtetit dhe partive opozitare lidhur me propozimin e BE-së, mund të ndikojnë në forcimin e

përpjekjeve të aleatëve për t'i adresuar disa prej shqetësimeve të Kosovës. “Mendoj se këto janë më shumë përpjekje për të marrë garanci prej partnerëve ndërkombëtarë se Kosovën e presin përfitimet që do të kishin ardhur prej njohjes dhe jo mbase detyrimisht njohja. Këto më shumë duken, thjesht, si lloj qëndrimi retorik dhe taktik”, ka thënë Maliqi.

Të enjten, më 26 janar, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se propozimi i Bashkimit Evropian për normalizimin e marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë duhet ta ketë njohjen reciproke në qendër. Këtë propozim ai e ka konsideruar si bazë të mirë për diskutime dhe si “kornizë që na mundëson të ecim përpara”.

Së fundmi, më 25 janar, në Prishtinë ka qëndruar i dërguari i posaçëm i Bashkimit Evropian për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajčak, i cili është takuar në një darkë pune me kryeministrin

Kurti, dhe zëvendëskryeministrin Besnik Bislimi, për të diskutuar për hapat e ardhshëm rreth dialogut. Ndërsa më 24 janar, këshilltari i Departamentit Amerikan të Shtetit (DASH), Derek Chollet, e ka inkurajuar kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, që ta pranojë propozimin e BE-së për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë.

Më 20 janar, në Prishtinë dhe Beograd, ka qëndruar Lajčak, i shoqëruar nga emisari amerikan për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, i dërguari i posaçëm i Francës, Emmanuel Bonne, ai i Gjermanisë, Jens Plotner, dhe Francesco Talon, këshilltar i kryeministres së Italisë. Ata kanë biseduar me kryeministrin Albin Kurti dhe presidentin Aleksandër Vuçiq lidhur me propozimin e Bashkimit Evropian për normalizimin e marrëdhënieve. Presidenti serb Aleksandër Vuçiq ka deklaruar se propozimi i BE-së është kornizë e re negociuese për Serbinë.

Kroacia mbështet Kosovën në aspiratat euroatlantike

PRISHTINË, 27 JANAR (ER) - Grupi i Miqësisë Kosovë - Kroaci në Kuvendin e Kosovës, së bashku me Komisionin për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti, kanë pritur në takim Grupin e Miqësisë me Kosovën të Parlamentit të Kroacisë. Në këtë takim është diskutuar për bashkëpunimin që të dy kuvendet kanë ndërtuar midis tyre ndër vite, me mundësinë për ta zgjeruar atë më tej në të gjitha nivelet e jetës parlamentare. Kryetari i Komisionit për Ekonomi, Ferat Shala dhe kryetari i Grupit të Miqësisë me Kroacinë,

Arbër Rexhaj, kanë shprehur gatishmërinë dhe interesimin për të ngritur në një nivel më të lartë marrëdhëniet dypalëshe në fusha të ndryshme të interesit reciprok. Ata kanë vlerësuar lart mbështetjen kroate për Kosovën në të gjitha fazat, duke theksuar rëndësinë që kjo përkrahje të vazhdojë edhe në të ardhmen. Ndërsa kryetari i Komisionit për Ekonomi, Zarko Tusek, duke e konsideruar Kosovën aleat dhe shtet mik të Kroacisë, ka thënë se mbështetja e Zagrebit zyrtar për Kosovën në procesin e anëtarësimit të saj në organizata

ndërkombëtare është interes strategjik për shtetin e tij. Edhe kryetari i Grupit të Miqësisë, Ante Bacic, ka vënë në pah gatishmërinë për ta ofruar përvojën dhe mbështetjen e Kroacisë në aspiratat euroatlantike të shtetit të Kosovës. Në këtë takim me diskutimet e tyre kontribuan edhe deputetë të tjerë të Kuvendit të Kosovës dhe atij të Kroacisë. Të dyja palët janë pajtuar për të gjetur rrugë të reja për avancimin e bashkëpunimit në sferën politike, ekonomike, prodhimtari, punësime sezonale, siguri, arsim dhe shëndetësi.



Rama viziton Skenderajn, Nura e falënderon për ndihmën

SKENDERAJ, 27 JANAR (ER) - Kryetari i komunës së Skenderajt, Fadil Nura, ka mirëpritur të premten në takim kryetarin e komunës së Prishtinës, Përparim Rama dhe nënkryetaren Donjeta Sahatçiu, me të cilët ka diskutuar për gjendjen aktuale pas përmbytjeve të javës së kaluar që kanë shkaktuar dëme të konsiderueshme në ekonomitë familjare, biznese dhe në bujqësi.

Të dy kryetarët kanë vizituar lagjen “Murtezaj” në qytet, një nga më të goditurat e vërshimeve, ku kanë parë nga afër pasojat e fatkeqësisë. Kryetari Nura e ka falënderuar kreun e kryeqytetit për ndihmën që ka ofruar për Drejtorinë e Arsimit gjatë përmbytjeve, ndërsa ka shtuar se komuna e Skenderajt mirëpret çdo mbështetje për të kaluar këtë situatë pas përmbytjeve.

Lladrovci dhe Ismajli nënshkruajnë pesë marrëveshje në fushën e energjisë

DRENAS, 27 JANAR (ER) - Kryetari i komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, ka takuar drejtorin menaxhues të Fondit të Kosovës për Eficiencë të Energjisë (FKEE), Ahmet Ismajli, me të cilin ka nënshkruar pesë marrëveshje të shërbimeve të energjisë. Marrëveshja për shërbime të energjisë është bërë për ShFMU “Migjeni”, “Shote Galica”, “24 Korriku” dhe “Shaban Polluzha” si dhe Ambulancën e Mjekësisë Familjare në fshatin Nekoc. Fondi do të investojë në renovimin e këtyre objekteve me masa eficiente, ku do të bëhet termoizolimi, ndërrimi i kulmit dhe izolimi i tij, ndërrimi i ngrohjes qendrore dhe

ndriçimi eficient. Vlera e këtyre marrëveshjeve është mbi 645 mijë e 870 euro. Me këtë rast, kryetari Lladrovci ka falënderuar drejtorin menaxhues të FKEE-së për investimet e deritashme dhe investimet që do të ndërmerren për kursimin e energjisë në këto pesë objekte me rëndësi për qytetarët dhe për komunën. Po ashtu, ata kanë diskutuar për mundësitë e investimit të masave eficiente në sektorin rezidencial, në objektet e banimit social që janë në komunën e Drenasit dhe në ekonomitë familjare me kushte të rënda sociale.



Komuna e Mitrovicës përfiton një kamion për mbeturina nga MMPHI-ja

MITROVICË, 27 JANAR (ER) - Të premten është mbajtur ceremonia e dorëzimit-pranimit të kamionëve për grumbullim të mbeturinave, në kuadër të projektit “Granti i Përfundimit për Mjedis të Pastër”, ku falë rezultateve të suksesshme, komuna e Mitrovicës është përfituese e një kamioni (skip/kiper) për mbeturina. Në ceremoninë e ndarjes së këtij granti ka marrë pjesë kryetari i komunës së Mitrovicës, Bedri Hamza, së bashku me drejtorin e Drejtorisë për Mbrojtje të Mjedisit, Egzon Sadiku dhe drejtorin e Drejtorisë për

Ekonomi dhe Zhvillim, Elvis Feka. Me rastin e pranimit të kamionit, kryetari Hamza ka thënë se komuna e Mitrovicës do të mbetet e përkushtuar për ofrimin e shërbimeve sa më të mira për qytetarët dhe për menaxhimin e mirë të mbeturinave, në mënyrë që të kemi mjedis sa më të pastër dhe të shëndetshëm në qytetin e Mitrovicës. Vlen të potencohet se ky kamion i dhuruar nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI) ka kushtuar gjithsej 156 525 66 euro.



Presidentja Osmani kujton viktimat hebreje në Ditën e Holokaustit

PRISHTINË, 27 JANAR (ER) - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, në Ditën Ndërkombëtare të Përkujtimit të Holokaustit, ka bërë homazhe te pllaka përkujtimore për hebrenjtë që janë zhdukur në kampet e nazistëve gjatë Holokaustit. Me këtë rast, Osmani ka thënë se kjo ditë shërben si një kujtesë e

mizorive të kryera gjatë një prej periudhave më të errëta të historisë dhe shërben si një thirrje për veprim për të gjithë ne për t'i kujtuar dhe nderuar viktimat e Holokaustit. “Nuk duhet të harrojmë asnjëherë mizoritë e së kaluarës dhe duhet të vazhdojmë të qëndrojmë kundër antisemitizmit, urrejtjes dhe

racizmit, sot dhe çdo ditë. Është e rëndësishme t'i kujtojmë edhe veprimet e shqiptarëve gjatë Holokaustit të cilët mirëpritën refugjatët hebrej krahëhapur, duke dëshmuar dhembshurinë dhe humanizmin. Kjo shërben si një kujtesë për fuqinë e mirësisë përballë së keqes”, ka thënë Osmani.



Abdixhiku: Gjendja në shëndetësi është e papranueshme

PRISHTINË, 27 JANAR (ER) - Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lumir Abdixhiku, është takuar të premten me disa punonjës shëndetësorë me të cilët ka biseduar për gjendjen në shëndetësi. Me këtë rast, Abdixhiku ka kritikuar qeverinë Kurti për gjendjen në shëndetësi. Në këtë kontekst, kryetari i LDK-së ka thënë se gjendja në këtë sektor është e papranueshme. “Pa penj, pa infuzione, pa doreza! Mëngjesin e së premtes e nisa me punonjës shëndetësorë të cilët ma konfirmuan atë që të gjithë e dimë tashmë: sistemi ynë shëndetësor është në pikën e thyerjes. Klinika të tëra

spitalore janë pa penj, pa doreza, pa infuzione e pa mjete higjienike bazike. Pacientët, familjarët e tyre, duhet t'i sjellin ato me vete para operimeve e intervenimeve. Për pacientët me kancer, në përballjen e tyre për jetë, nuk ka barna. Tani kur kostoja e jetës është e papërballueshme, ata duhet t'i blejnë ato vetë. Ndërsa qeverisë i kanë tepruar mbi 1.3 milion euro të dedikuara për barna e material bazik gjatë vitit 2022. Tepriçë parash kur nuk ka as penj! Kjo gjendje është thjeshtë e papranueshme. Kosova meriton më mirë. Kosova mundet më shumë!”, ka shkruar Abdixhiku në “Facebook”.



Kurti: Austria, partnere dhe mike e rëndësishme e Kosovës



PRISHTINË, 27 JANAR (ER) - Kryeministri i Republikës së Kosovës, Albin Kurti, ka pritur të premten në takim përfaqësuesit e Shoqatës së Miqësisë Austri - Kosovë. Në delegacion ishin të pranishëm edhe Lukas Mandl, deputet i Parlamentit Evropian, njëherësh themelues dhe president i Shoqatës së Miqësisë Austri - Kosovë, Christoph Weidinger, ambasador i Austrisë në Kosovë, Friedhelm Frischenschlager, ish-ministri i Mbrojtjes i Austrisë, si dhe deputetët në Parlamentin e

Austrisë, Hannes Taborsky dhe Helmut Brandstätter. Kryeministri Kurti ka shprehur mirënjohje për mbështetjen e dhënë nga Austria, shtet mik i madh i Kosovës dhe partner i rëndësishëm. Në këtë takim janë vlerësuar si shumë të mira marrëdhëniet bilaterale ndërmjet dy shteteve. “U bashkëbisedua për projektet e përbashkëta me Austrinë si dhe për mundësitë e zgjerimit të bashkëpunimit të mëtejshëm, me theks të veçantë në projektet kulturore”, ka njoftuar zyra e kryeministrit.

Reka takon njërin nga veprimtarët më të devotshëm shqiptaro-amerikan të Nju Jorkut

NJU JORK - 27 JANAR - Shefi i Misionit në Konsullatën e Përgjithshme të Republikës së Kosovës në Nju Jork, ambasadori Blerim Reka, është takuar me një nga veprimtarët e devotshëm shqiptaro-amerikan të Nju-Jorkut, Richard Llukaj. Reka e ka falënderuar Llukajn për ndihmën e vazhdueshme

për shumë projekte kombëtare ku, sipas tij, në kohën kur zëri ynë nuk dëgjohej, ky afarist ishte dhe mbeti zëri ynë që respektohej në qarqet zyrtare amerikane. “Kënaqësi të takoja z. Richard Llukaj, një nga veprimtarët e devotshëm shqiptaro-amerikan të Nju-Jorkut dhe ish-kryetarin e Këshillit Kombëtar Shqiptaro-

Amerikan (NAAC). E falënderova afaristin e suksesshëm dhe filantropin zemërgjerë për ndihmën e vazhdueshme për shumë projekte kombëtare. Në kohën kur zëri ynë nuk dëgjohej, ai ishte dhe mbeti zëri ynë që respektohej në qarqet zyrtare amerikane”, ka shkruar Reka në “Facebook”.



Murati për rritjen e faturave të tatimit në pronë fajëson ish-qeveritë e kaluara

**EPOKA
ERE** **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 27 JANAR - Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati, ka thënë se vendimi për rritjen e faturave të tatimit në pronë padrejtësisht po tentohet t'i mëveshët qeverisë Kurti. Ai në një konferencë për media të premtën ka thënë se ky vendim është marrë në qeverinë Mustafa, por ky hyrë në fuqi në kohën kur ekzekutivin e udhëhiqte Ramush Haradinaj. Ai ka thënë se ligji në fjalë i miratuar në vitin 2018 ka paraparë sipas nenit 7 që në vitin e pestë të zbatimit të tij të hyjë në fuqi tatimi 100 për qind i tokave. “Këtu duhet të kthehemi te ligji që ka qenë i miratuar në vitin 2018 për tatimin në pronë. Ky ligj fillimisht ishte miratuar nga qeveria Mustafa më 4 maj të vitit 2017, kur ministër i Financave ishte Avdullah Hoti. Por, ky ligj nuk kishte arritur të miratohet në Kuvend dhe të hyjë në fuqi sepse qeveria kishte rënë një javë më vonë. Proceja, i njëjti ligj është proceduar në qeverinë

Haradinaj disa muaj më vonë, diku në nëntor ose dhjetor dhe më 26 janar të vitit 2018 është publikuar në gazetën zyrtare. Pra, më herët s'ka qenë tatimi i tokave dhe prej hyrjes në fuqi të këtij ligji kanë hyrë edhe tokat, pasi më herët s'kanë qenë tokat, por vetëm ndërtesat. Pjesa më e madhe e rritjes së faturave shkon nga ky tatim”, është shprehur Murati. Ai tha se arsyeja e dytë për rritjen e disa faturave të tatimit në pronë ka të bëjë me vlerësimin e pronave rezidenciale, por edhe me shkallën tatimore. “Për vlerësim obligohet Ministria e Financave, që të bëhet vlerësimi me automatizëm e që me udhëzimin administrativ të nënshkruar në vitin 2018 është përcaktuar që rivlerësimi i pronave rezidenciale të bëhet çdo tri vjet. Edhe kjo ka qenë e paracaktuar më herët që duhet të ndodhë dhe është obligim ligjor që vlerësimi të bëhet me çmimet e tregut. Kurse kushti i dytë ka të bëjë me shkallët tatimore që i obligon komunat që t'i përcaktojnë shkallët tatimore sipas nenit 9, i cili thotë se shkallët tatimore

përcaktohen për llojet e pronave dhe ka një interval prej 0.15 % deri në 1 % që komunat mund ta caktojnë për të rritur apo për ta ulur tatimin në pronë”, ka theksuar Murati. Ministri i Financave, Hekuran Murati, ka thënë se është e padrejtë nga disa komuna që kanë bërë politikë me çështjen e tatimit në pronë pasi, siç ka thënë ai, tatimi në pronë mbledhet nga komuna dhe janë të hyra komunale. Ai në këtë konferencë për media ka theksuar se tatimi në pronë është e hyrë komunale dhe u takon komunave të tregojnë se çfarë duan të bëjnë tash pasi, sipas tij, Ministria Financave është e gatshme të mbështesë çfarëdo kërkesë që kanë komunat për ulje të tatimit të vitit aktual. “Duhet të sqarohet se tatimi mbledhet nga komuna dhe janë të hyra komunale”, ka thënë Murati, duke shtuar se ka pasur pretendime se qeveria ka rritur tatimet për të rritur të hyrat. “Mirëpo meqenëse janë të hyra të komunave, u takon komunave të na tregojnë se çfarë duan të bëjnë. Ne si

ministri, qeveri, jemi të gatshëm të mbështesim çfarëdo kërkesë që kanë komunat për ulje të tatimit të vitit aktual, qoftë duke shkuar për të gjithë njësoj, ose duke marrë një prag ose përqindje të rritjes për ta falur si tatim në

mënyrë që të mos ngarkohen qytetarët. Synimi i qeverisë është të ndihmohen qytetarët në këto kohë të vështira, por është e padrejtë që nga disa komuna është bërë politikë me këtë çështje”, ka thënë ministri Murati.

Murati: Koeficienti për Ligjin e Pagave nuk po mbahet fshehtë, po përlllogaritët nga informatat që vijnë

Ministri i Financave, Hekuran Murati, ka thënë se çështja e koeficientit për Ligjin e Pagave, i cili pritet të hyjë në fuqi në fillim të muajit shkurt, nuk është duke u mbajtur fshehtë. Murati ka thënë se vlera e koeficientit është duke u përlllogaritur nga informatat që vijnë nga organizata të


caktuara. “Disa çështje u takojnë dikastereve të tjerë. Ekipet po punojnë në aktet nënligjore. Edhe për koeficientin dhe tema të tjera do të përditësohen. Koeficienti nuk është duke u mbajtur fshehur. Po përlllogaritët ashtu siç vijnë informatat në organizatat buxhetore”, ka thënë Murati.

ATK-ja krijon mundësinë e pagesës e tatimit me këste

PRISHTINË, 27 JANAR - Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) ka njoftuar se ata që kanë vështirësi për t'i paguar obligimet e tyre tatimore tashmë kanë të drejtë të kërkojnë t'i paguajnë me këste për një periudhë të caktuar. “Nga tatimpaguesi pritët që ta paguajë detyrimin tatimor në

shumën e duhur dhe në kohën e duhur, siç është e përcaktuar me ligj. Nëse tatimpaguesi ka vështirësi të përkohshme financiare të cilat mund të shkaktojnë vonesa në shlyerjen e obligimeve tatimore, tatimpaguesi ka të drejtë të kërkojë që obligimet t'i paguajë me këste, duke bërë

një plan pagese për një periudhë të arsyeshme kohore”, ka njoftuar ATK-ja, duke shtuar se për ta bërë këtë, tatimpaguesi duhet të dëshmojë për vështirësitë financiare, të dakordohet me ATK-në për një marrëveshje të arsyeshme për pagesa dhe ta respektojë atë marrëveshje.



Colette: Shkrimtarja më dashur franceze e të gjitha kohërave

Nga: John SELF / BBC

Sa kohë ka jetuar Colette, edhe pas vdekjes së saj! – ka shkruar gazetarja Janet Flanner, në vitin 1967. Më shumë se gjysmë shekulli më vonë, Colette ende jeton dhe kjo javë shënon 150 vjetorin e lindjes së saj. Për ta shënuar këtë rast, *NYRB Classics* ka botuar përkthimin e ri të dy kryeveprave të saj, *Chéri* (1920) dhe *The End of Chéri* (1926), të përkthyer nga Paul Eprile – dhe kjo shihet si mundësi e mirë për të eksploruar jetën dhe veprën e shkrimtares franceze të dashur në mënyrë shumë të veçantë.

Fama e Colettes shtrihet në të qenit ndoshta e vetmja shkrimtare grua e njohur me mononimin e saj – është gjithmonë dhe e vetmja Colette, megjithëse në fakt ky emri më femëror ishte mbiemri i saj: lindi si Sidonie-Gabrielle Colette më 28 janar 1873, në fshatin francez të San-Sover-on-Pysai.

Puna e saj – kryesisht në formë novelash, të shkurtra dhe të mprehta – mbijeton sepse subjekti i saj kryesor është ai që nuk del kurrë nga moda. “Dashuria, buka dhe gjalpi i penës sime”, shkruante ajo, megjithëse e shprehu më troç në librin e saj *The Pure and the Impure* (1932): *Trupi, gjithmonë trup, misteret dhe tradhtitë dhe frustrimet dhe befasishtë e trupit*. André Gide, ajo pika e shkëlqyer e lidhjes së letërsisë franceze të shekullit XX, u pajtua me këtë, duke lavdëruar veprën *Chéri* për *inteligjencën, zotërimin dhe kuptimin e sekreteve më pak të pranuar të trupit*.

Historia e Colettes dhe vepra e saj është një nga më të habitshmet në letërsinë moderne. Ishte pioniere e shkollës franceze të autofiksionit (fiksion autobiografik), duke shkruar për jetën e grave në mënyrat që hapën terrene të reja. Librat e saj ishin njëkohësisht të njohur dhe të vlerësuar – të lexuar nga kritikët dhe publiku – për të mos thënë edhe skandaloze. Dhe, e bëri jetën e vet projekt po aq magjepsës sa librat. Por, për ta kuptuar atë – produktivitetin e saj pjellor, paraqitjen e saj, ekspertizën e saj në misteret e zemrës njerëzore dhe oreksin për ta përfshirë veten në libra, paksa e maskuar ose aspak – fillimisht duhet të kuptojmë se në radhë të parë ajo gati sa nuk mbeti pothuajse e panjohur.

Katër librat e saj të parë ishin kronikat e nxënësës imagjinare franceze Claudine – *Claudine at School* (1900), *Claudine in Paris* (1901), *Claudine Married* (1902) dhe *Claudine and Annie* (1903) – të cilat i shkroi me porosi të burrit të saj të parë Henry Gauthier-Villars, gazetar dhe redaktor i njohur me pseudonimin më pak elegant Willy. Pasi i shkroi ato – herë-herë e mbyllur në një dhomë për ta nxitur veten për t’i përfunduar – u zbukuruan me disa sugjerime editoriale nga Willy (*Ca energji vajzërore ... e kupton çfarë dua të*

them?) dhe Willy kërkoi t’i botonte me emrin e vet dhe i ruajti të drejtat e autorit dhe honorarët.

Në raportet për jetën e Colettes, fjala e zakonshme për të përshkruar Willyn është “mjerim”, dhe kështu ishte, por ai ia dha Colettes një shije për jetën kulturore parisienne – e takoi Marcel Proust, Maurice Ravelin, Claude Debussyn dhe të tjerë – dhe bëri të veten për të shtuar shitjet e librave “të tij”, të cilat ishin të ngadalta derisa nuk organizoi tre nga miqtë e tij që të shkruajnë komente të favorshme. Shpejt, *Claudine at School* merr veten dhe në kohën kur seria përfundoi, librat ishin aq të njohur sa u bënë inskenimet teatrale dhe u përdorën në një sërë mallrash, përfshirë cigaret *Claudine*.

Sipas definicionit, librat ishin punë trajnuese – Colette i shkroi në të njëzetat e saj, e detyruar – por, për një shkrimtare që nisi të lexojë Balzacun në moshën shtatëvjeçare, kjo nuk është kritikë. Claudine u bë ajo që biografi i Colettes, Judith Thurman, e quajti *adoleshentja e parë e shekullit*, me përrthithjen e saj si sfungjer të sjelljes së të rriturve. Dhe, në libra ne shohim zhvillimin e mjeshtërisë së Colettes në përshkrimin sensual, si dhe kërkimin e saj të parë për jetën e vet si material (që mund ta bëjë leximin e skenës së natës së dasmës në *Claudine Married* si përvojë disi voajeriste). Pikërisht në këta libra, gjithashtu pamë trajtimin e parë të Colettes për dashurinë në letërsi – megjithëse *Claudine in Paris* është ndoshta libri i fundit ku Colette do të shkruajë për dashurinë në mënyrë jokritike, romantike, pa dinamikën e fuqisë dhe paqartësinë që e bëri pikante punën e saj të mëvonshme (*Burrat janë të tmerrshëm* – shkroi ajo një herë, duke shtuar: *Edhe gratë*).

Colette dhe Willy u ndanë më 1906, dhe vitin e ardhshëm botoi (nën emrin Colette Willy) *Retreat from Love*, që vazhdon rrëfimin e *Claudine and Annie*, dhe ku në parathënie dha këtë deklaratë: *Për arsytet që nuk kanë të bëjnë fare me letërsi, kam pushuar bashkëpunimin me Willyn*. Më në fund ishte e lirë.

Megjithatë, me Willyn që ruante ende të drejtat nga librat me personazhen Claudine, Colette ishte pa para dhe për të fituar u bë interpretuese në skenat muzikore. Kjo i shkonte për shtat ndjenjës së saj të performancës dhe i mundësoi të luante me rolet gjinore: një minutë e veshur si burrë me kostume, tjetri duke pozuar me gjoks të zhveshur në pantomimën seksuale *The Flesh*. Përvoja e saj në skenat e muzikës e frymëzoi për romanin e saj të vitit 1910, *The Vagabond*, histori shumë autobiografike e interpretueses Renée Néré dhe një dashnori që ajo e quan “The Big Noodle” – vepër që shtrou pyetje moderne rreth ndarjes mes dashurisë dhe seksit dhe se si shoqëria kërkon t’i



kontrollojë të dy këto nëpërmjet institucionit të martesës (një institucion për të cilin, natyrisht, Colette dhe për rrjedhojë Renée, kishin skepticizëm të madh). Ishte *Vagabondi* që e katapultoi Coletten drejt vlerësimit letrar, për herë të parë, dhe libri fitoi tri vota për çmimin prestigjioz Prix Goncourt. Koha e saj në skenën muzikore mund ta ketë nxitur interesin e saj për ta vendosur veten në qendër të skenës të veprave të saj. Një nga shembujt e saj më të mirë për këtë është romani i mëvonshëm *Chance Acquaintances* (1940), në të cilin rrëfimtaria Colette viziton një institucion shëndetësor ku gratë e pasura (me flokët sipas modës) u nënshtrohen kurave të dyshimta: dushi i hundës, dhomat me avull, shpëlarja e veshkave. Atje takon një burrë e grua, Haumesët. Zonja Haume nuk është mirë, ndërsa M Haume ka pamjen e “dikujt me shumë pak mend në kokë”. Megjithatë, Colette zbulon se M Haume ka një lidhje dhe se e dashura e tij, e kthyer në Paris, rri e heshtur për të. Natyrisht, ky është territori ideal i Colettes, dhe ajo pranon të vizitojë të dashurën e tij në Paris për të zbuluar historinë e vërtetë. Komploti tregon oreksin e Colettes për të keqen, si dhe interesin e saj të qëndrueshëm për trillet e zemrës njerëzore, ndërsa M Haume zbulon se *kur futet në lojë intriga, një grua kurrë nuk harron se instinkti femëror është më i vjetër në hile*.

Pas Willyt, burri i dytë i Colettes, Henry de Jouvenel, mund të ishte veçse një përmirësim, dhe si redaktor i gazetës kryesore *Le Matin*, ai ishte gjithashtu në gjendje të botonte punën e gruas së vet. Por, as kjo nuk e çliroi, meqë u detyrua të braktiste botimin e serisë së libri të ri, *Ripening Seed* (1923), për shkak të tronditjes që u shkaktoi lexuesve, dhe ai e pyeti atë se pse nuk mund të shkruajë romane që nuk janë imorale.

Ripening Seed ishte romani që zgjeroi interesin e Colettes për dashurinë, fuqinë dhe seksualitetin në periudhën e lulëzimit të adoleshencës, përmes miqve adoleshentë Philip (i paduruar për t’u rritur) dhe Vinca (me sytë e saj të bardhë dhe të kaltër si mëtriku). Kanë qenë 15 vjet së bashku, si binjakë të pastër dhe të dashur dhe duket se do të zhvillojnë miqësinë,


megjithëse Philipi do të zbulojë se *zotërimi është mrekulli që nuk realizohet aq shpejt*. Por, marrëdhënia e tyre e thjeshtë ndërlikohet kur Philipi joshet nga një grua e moshuar: dhe edhe kjo erdhi nga jeta, pasi në moshën 47-vjeçare Colette pati një lidhje me djalin 16-vjeçar të burrit të saj, Bertrand de Jouvenel. *Ripening Seed* është roman shumë sensual, që nuk zbavitet vetëm me kënaqësitë trupore (*buzët e pjekura si frutat e djegura nga vapa e ditës*), por në aromat dhe pamjet e peizazhit bregdetar të Bretanjes. *Ripening Seed* u botua gjatë arritjeve më të mëdha artistike të Colettes, *Chéri* dhe *The End of Chéri*. Libri i parë flet për një kurtizane të moshuar, Léa de Lonval, dhe *Chéri*, burri shumë i bukur, shumë i ri me flokë si pendët e një zogu të zi dhe me gjoks me muskuj të fortë, të cilin prej vitesh ajo e ka edukuar në fushën e dashurisë. Komplikimet, si gjithmonë, lindin kur Léa vendos se është koha që *Chéri* i saj të vazhdojë. Romancierja Amy Bloom e quajti *Chéri*-n si *libër për rëndësinë e dashurisë, dështimin e dashurisë, [dhe] për mënyrën se si njerëzit e dashuruar shpeshherë arrijnë të zhgënjëjnë veten dhe të dashurit e tyre*. Në rreshtat përmbyllëse të *Chéri*-t, heroi ynë mbush mushkëritë me ajër si një i arratisur. Por, nuk ka mbaruar ende me të: pjesa shoqëruese, *The End of Chéri*, na paralajmëron për paqartësinë që në rreshtat e hapjes, teksa *Chéri* largohet nga shtëpia e vet, duke mos menduar prej vitesh për Léan (*Ah! Është bukur jashtë*. Ai menjëherë ndërroi mendje. *Jo nuk është*). Dhe, kur hyn në një apartament të shokëve, duke hasur në një plakë me mbipeshë me krahët e trashë si kofshët, e njeh të qeshurën e saj – dhe ne e dimë se gjithçka nuk do të përfundojë mirë këtë herë.

Kur botohet *The End of Chéri*, Colette ishte 53 vjeçe, me shumë vepra të shkëlqyera që do të vijnë. *The Pure and the Impure*, të cilin e konsideronte se një ditë do të çmohet si libri i saj më i mirë, ishte vepër kujtimesh për temën e gjinisë dhe seksualitetit: Colette kishte marrëdhënie me gratë dhe me burrat, përfshirë mbesën e Napoleonit, Mathilde de Morny. Libri eksploron marrëdhëniet mes

burrave dhe grave, grave dhe grave dhe mbulon transvestizmin dhe homoseksualitetin (ose, siç e thotë Colette në përshkrimin e saj për shoqen Pauline Tarn, *këtë poete që nuk pushoi kurrë së pretenduari lidhjen farefisnore me Lesbosin*). Por, vepra për të cilën u bë më e njohur në botën anglishtfolëse ishte *Gigi* (1944), që kishte elemente të njohura – historia e një gruaje të re dhe një burri më të moshuar (e kundërta me *Chéri*), me gruan e re që trajnohet si kurtizane. Ishte një nga librat e fundit që shkroi, në moshën 70-vjeçare dhe e gjymtuar nga artriti. Dhe, si reagim ndaj rrethanave të saj e bëri atë më të lehtë, më pak cinik dhe më optimist se shumicën e veprave të saj të mëparshme (janë ndoshta këto cilësi që e kanë bërë kaq popullore). *Gigi* u bë mjuzikël dhe film i famshëm; prodhimi skenik e bëri yll Audrey Hepburnin dhe për rol ajo u zgjodh personalisht nga Colette.

Fantastika e Colettes në Francë nuk ishte gjithmonë, në atë kohë, njëjtë e krahaseshme jashtë vendit. Revista *Time* në vitin 1934 i referohej Colettes si shkrimtare *nën mesatare*, pasi kishte shkruar më parë se ishte *furnizuese për ata që pëlqejnë afrodiziakët e lehtë në shtyp* (ndërsa pranoi se kjo kategori përfshinte 99.44 për qind të të gjithë lexuesve). Megjithatë, lexuesit e mprehtë e adhuruan atë, përfshirë shkrimtarin Truman Capote i cili i tha mikut të tyre të përbashkët, Jean Cocteau, se Colette është shkrimtarja e gjallë franceze që ai admiron më shumë (përfshirë këtu, natyrisht, Cocteaun). Cocteau e krijoi me guxim një takim në vitin 1947, megjithëse Capote – i cili e përshkroi takimin në esenë e tij *The White Rose* – ishte aq i mahnitur saqë kaloi pjesën më të madhe të kohës së tij me Coletten duke admiruar koleksionin saj të peshave antike të kristalit që mbajnë fletët.

Në vendin e saj, në Francë, Colette ishte yll. Ishte gruaja e dytë që u bë oficer e lartë e Legionit të Nderit dhe e para për të cilën u organizua funerali shtetëror pas vdekjes së saj më 1954, në moshën 81-vjeçare. Puna e saj nuk e shqetësoi lexuesin me politikën apo me çështjet botërore. Kanavaca e saj ishte ajo që Tolstoi e quajti tragjedia më torturuese e njeriut – *tragjedia e dhomës së gjumit*. E eksploroj fushën e saj pa u lodhur dhe pa e përsëritur veten, duke ndryshuar qasjen e saj: sa më shumë piquej në më shumë eksperiencë, këndvështrimi ndryshonte si hije kur dita afrohet. Intensive dhe sensuale, letërsia i saj është plot jetë dhe të qeshura, teksa vazhdoi të tregojë historinë e jetës së një gruaje nga fëmijëria në moshë të shtyrë. Kjo është arsyeja se pse, 150 vjet pas lindjes së saj, Colette ende jeton. /Telegrafi/



Prishtina fiton ndaj Lokomotiv Plovdivit, realizon edhe portieri Nika

Antalia, 27 janar - FC Prishtina e ka zhvilluar edhe ndeshjen e fundit miqësore në Antalya të Turqisë. Skuadra kryeqytetase e ka mposhtur FC Lokomotiv

Plovdiv me rezultat bindës 3-1. Në minutën e 19 portieri Ardit Nika ka realizuar gol nga porta në portë, kurse për dy golat e tjerë është përkujdesur Endrit

Krasniqi që realizoi dy gola në minutën e 34-t dhe 45-të. Klubi që drejtohet nga Ismet Munishi është në mesin e favoriteve në garën për titull të kampionit në

Kosovë, derisa sezonin vjeshtor e mbylli në pozitën e tretë me 27 pikë, 11 pikë me pak se dy skuadrat e para: Drita dhe Ballkani.



Kuvendi miraton statutin e ri të FFK-së

Prishtinë, 27 janar - Me 48 vota për, asnjë kundër e një abstenim, është miratuar statuti i ri i FFK-së në kuvendin e jashtëzakonshëm që u mbajt të premten në selinë e FFK-së. Ky statut është hartuar nga ekspertë të FFK-së dhe të UEFA-s e FIFA-s. Kuvendi nisi me intonimin e himnit shtetëror, derisa me një fjalë rasti të pranishmëve iu drejtua presidenti Agim Ademi. Ai theksoi se hartimi i statutit është bërë nga tre ekspertë të FIFA-s, dy të UEFA-s dhe ekspertë të FFK-së. “Ne e kemi planifikuar që këtë statut ta miratojmë në Kuvendin e rregullt të punës, por meqenëse miratimi i statutit ishte një nga kriteret për licencim nga MKRS-ja, ne kemi ftuar kuvendin e jashtëzakonshëm. Besoj se miratimi i këtij statuti do të na sjellë edhe licencimin nga MKRS-ja. Bazamenti është në UEFA e FIFA, pasi për herë të parë këto dy



institucione e kanë një statut unik dhe mund të them se ne e kemi fatin që po thuajse jemi federata e parë që e aplikon këtë statut model”, ka theksuar Ademi. Punimet e Kuvendit i ka përshëndetur edhe presidenti i KOK-ut, Ismet Krasniqi, i cili

përgëzoi hartimin e statutit të ri dhe shprehu shpresën se ndryshimet e bëra në këtë statut do të jenë në dobi të futbollit dhe të të gjitha klubeve. Po ashtu, të pranishmit në emër të presidentit të UEFA-s, Aleksandër Čeferin, i përshëndeti Luca Nicola, derisa me një

shkresë këtij kuvendi iu drejtua edhe FIFA, e cila përgëzoi hartimin e Statutit të ri. Të pranishëm ishin edhe përfaqësuesit e Ministrisë së Sportit si dhe ata të Federatës Shqiptare të Futbollit. Pas fjalimeve, u.d. sekretari i përgjithshëm, Taulant Hodaj, paraqiti disa prej ndryshimeve më të rëndësishme në draft-statut dhe më pas hapi debatin për delegatët. Tre delegatë shprehën pakënaqësitë e tyre lidhur me procesin e draftimit të këtij statuti, për çka nga presidenti Ademi u udhëzuan që në të ardhmen ato t'i paraqesin me shkrim dhe në kuvendet e ardhshme t'i paraqesin për miratim. Ndërkaq, delegati Tahir Batatina përgëzoi punën e bërë dhe theksoi nevojën për t'u miratuar ky statut, në mënyrë që t'i hapet rruga licencimit të FFK-së nga MKRS-ja e që, sipas tij,

zgjatja e këtij procesi më së shumti po i dëmton klubet. Krahas statutit të ri, delegatët e Kuvendit miratuan me shumicë votash edhe Rregulloren e Kuvendit të Punës si dhe Rregulloren e Këshillit Mbikëqyrës, të cilat, po ashtu, kanë qenë kriteret për licencim nga MKRS-ja. Në fund, presidenti Ademi falënderoi të gjithë delegatët për vendimin e tyre të arsyeshëm për miratimin e Statutit të ri dhe theksoi se së bashku me KE-në do të vazhdojë të mbrojë interesin e futbollit dhe nevojave të klubeve. Ai i ftoi edhe delegatët që shprehën pakënaqësi dhe që braktisën punimet e kuvendit t'i thërrasin arsyet, teksa theksoi se është e drejta e tyre që të mendojnë ndryshe, por kudo në botë demokracia e ka kështu, ku shumica pajtohet e dikush jo, por ka thënë se do të punojë për t'i realizuar edhe kërkesat e tyre.

Sonte përballen nënkampioni dhe kampioni

PRISHTINË, 27 JANAR - Fundjava do të dhurojë superndeshje në Prince Caffè Superligë, kryetësisht javën e 20. Ndeshja kryesore do të zhvillohet ndërmjet Trepçës dhe Golden Eagle Yllit apo nënkampionit dhe kampionit aktual të Kosovës. Mitrovicasit kanë pasur luhatje gjatë këtij edicioni, ku numërojnë dhjetë fitore e nëntë humbje, ndërsa therandasis, pasi nuk e nisën mirë kampionatin me katër humbje, tani kanë 15 fitore radhazi, duke qenë liderë në renditje. Në këtë edicion në elitë, kampionët kanë dy fitore ndaj nënkampionit. Takimi në Mitrovicë pritet të jetë shumë interesant. Sfida e parë do të zhvillohet ndërmjet Ponte Prizrenit dhe Vëllaznimit, ku të dyja skuadrat kanë shtatë fitore e 12 humbje, andaj do të jetë shumë e rëndësishme për të dyja

skuadrat që duan të jenë pjesë e “play-off”-it. Të dielën ndeshen dy skuadrat me traditë në basketbollin e Kosovës, Bashkimi dhe Peja. Prizrenasit kanë tetë fitore e 11 humbje, ndërsa pejanët 13 fitore e gjashtë humbje. Ndeshja e fundit e kësaj jave është ndërmjet Rahovecit dhe Sigal Prishtinës. “Vreshtarët” janë në vendin e fundit me vetëm dy fitore e 17 humbje, kurse prishtinasit kanë ngritje të formës

PRINCE CAFFE SUPERLIGA - Java 20

Të shtunën takohen:
17:00 Ponte Prizreni - Vëllaznimi
19:00 Trepça - Golden Eagle YLLI

Të dielën takohen:
17:00 Bashkimi - Peja
19:00 Rahoveci - Sigal Prishtina

në ndeshjet e fundit, ku numërojnë 14 fitore e pesë humbje deri më tani, duke u pozicionuar në vendin e dytë në tabelë.

Prishtina - Penza, derbi i xhiros së 14-t

Gjatë fundjavës zhvillohet xhiro e 14-t në Superligën e Femrave. Përballja kryesore e kësaj jave do të zhvillohet në kryeqytet në mes të Prishtinës dhe Penzës. Vashat bardhë e kaltër në këtë edicion kanë arritur të regjistrojnë 10 fitore e tri humbje, kurse në anën tjetër vajzat nga Peja kanë arritur tetë fitore e pesë humbje. Të shtunën zhvillohet edhe ndeshja në mes të Trepçës e Bashkimit. Lideri Bashkimi vazhdon ecurinë pozitive me 13 fitore në po aq ndeshje të



zhvilluara, ku është skuadra e vetme pa humbje në elitë, ndërsa skuadra mitrovicase ka katër fitore e nëntë humbje. Lojë interesante pritet të zhvillohet edhe në Gjakovë të dielën nga ora 18:00.

Vëllaznimi pret në shtëpi United Basketball. Skuadra nga Gjakova nuk ka arritur ende asnjë fitore këtë edicion, ndërsa vajzat nga Gjlani kanë regjistruar katër fitore e nëntë humbje.

Egnatia shkarkon Duron

Rrogzhinë, 27 qershor - Shpëtim Duro nuk do të jetë më trajner i Egnatias. Lajmin e ka dhënë klubi rrogzhinas me

anë të një njoftimi në rrjetet sociale. Shkarkimi ka ndodhur për shkak të rezultateve të dobëta teksa klubi ka nisur nga

puna për ta gjetur zëvendësuesin e Duros. “KF Egnatia njofton se Shpëtim Duro nuk do të jetë më trajneri

i ekipit. Klubi e falënderon për punën e bërë dhe i uron suksese në karrierë”, thuhet në njoftimin e Egnatias.



Trajneri i Al-Nassrit fajëson Ronaldon për eliminimin nga Superkupa

Riyadh, 27 janar - Al-Nassri nuk ia doli në gjysmëfinalen e Superkupës së Arabisë Saudite pasi u mposht 3-1 nga Al-Ittihad. Një eliminim dhe rezultat i cili nuk ka lënë aspak shije të mirë te skuadra, trajneri dhe për më

tepër te Cristiano Ronaldo, i cili në këtë përballje zhvilloi ndeshjen e dytë zyrtare me skuadrën e tij të re dhe u mjaftua me vetëm një goditje në portë. Në përfundimin e ndeshjes, trajneri i Al-Nassr, Rudi

Garcia, fajësoi pjesërisht portugezin për eliminimin, me francezin i cili priste diçka më shumë nga pesë herë fituesi i “Topit të Artë”. “Natyrisht që nuk jam i lumtur, prisja shumë më shumë nga skuadra, të

paktën nga elementët që janë në gjendje ta bëjnë diferencën. Një nga gjërat që mund ta ndryshonte rrjedhën e ndeshjes ishte ai rast i shpërdoruar nga Cristiano në pjesën e parë”, ka deklaruar Garcia.



Humbja e tretë radhazi për Bostonin

Boston, 27 janar - Humbja e tretë radhazi për ekipin e Bostonit, që u mund me rezultat 120-117 nga New Yorku pas kohës shtesë. Një ndeshje e ekuilibruar, ku për Bostonin nuk mjaftuan 35 pikët e 14 reboundet e Tatumit. Për nju-jorkezët u dalluan Randle me 37 pikë e Brunsoni me 29 pikë. Humbet edhe Brooklyn, që në shtëpi u ndal me rezultat 130-122 nga Detroiti. Tetë lojtarë të Detroitit realizuan mbi 10 pikë (Bey me 25 pikë më i miri),



REZULTATET		
Boston - New York	117-120	
Brooklyn - Detroit	122-130	
Charlotte - Chicago	111-96	
Houston - Cleveland	95-113	
Phoenix - Dallas	95-99	
Clippers - San Antonio	138-100	

ndërsa 40 pikët e Irvingut për Netsin mbetën për statistikë. Dallasi fitoi me rezultat 99-95 në fushën e Phoenixit, por lajmi i keq është dëmtimi i Donqiqit (ndrydhje e kavigjes

pas vetëm tre minutash lojë). Për Dallasin u dallua Dinwiddie me 36 pikë. Skuadra e clippersave, falë 35 pikëve të Paul Georges, e mposhti me shifrat 138-100 San Antonion.

Massa kritikon Alonson, lavdëron Schumacherin



Sao Paulo, 27 janar - Piloti brazilian Felipe Massa arriti 11 fitore e 41 podiume në Formula 1 gjatë karrierës së tij. Ai iu afrua shumë titullit kampion për pilotë në vitin 2008, që e humbi në kthesën e fundit, në garën e shtëpisë (titullin e mori Hamilton). Në një intervistë, 41-vjeçari brazilian nuk i ka kursyer kritikën ndaj ish-shokut të tij të skuadrës te Ferrari, Fernando Alonso. “Kam qenë te Ferrari me shumë kampionë, por jo gjithmonë gjërat kanë shkuar mirë. Fernando Alonso, pa

dyshim, ka qenë shoku im më i vështirë i skuadrës me të cilin jam përballur”, ka thënë Massa, që me spanjollin ishin së bashku te Ferrari në vitin 2010 deri në vitin 2013. “Alonso ishte një pilot i jashtëzakonshëm, por të punoje në një skuadër me të ishte e vështirë. Skuadra ishte e ndarë dhe kjo nuk e ndihmonte punën tonë. Ndërsa unë nuk kisha forcën që Ferrari të më dëgjonte në këtë drejtim”, shprehet Massa, që ka mendim tjetër për Michael Schumacherin, shok skuadra me

të në vitin 2006 te “kokëkuqja”. “Të ishe shoku i skuadrës së Michaelit ishte fantastike. Kam mësuar shumë nga ai, një pilot i jashtëzakonshëm, që kishte një metodë pune unike. Ishim shumë të lidhur”, shprehet Massa, që më pas shkoi te Williamsi. “Nuk i ndryshoj presjen karrierës time, pasi jam argëtuar shumë, ishte një përvojë unike. E vetmja gjë që do të ndryshoja është të kisha një pikë më shumë në vitin 2008 kur humba botërorin”, ka deklaruar Massa.

SHKURT

Broja në mesin e lojtarëve më të shpejtë në botë

Armando Broja nuk po kalon një moment mjaft të mirë me Chelsean, me dëmtimin e marrë përpara disa javëve, gjë që do ta lërë atë jashtë fushave deri në fund të sezonit. Gjithsesi, sulmuesi shqiptar ka marrë një vlerësim nga portali i njohur “Discover Top Speed”, duke u bërë pjesë e 30 lojtarëve më të shpejtë në botë. 21-vjeçari renditet në vendin e 18, me një mesatare prej 35.3 kilometrash për orë, duke lënë pas edhe lojtarë si Hakimi, Hadson-Odoi dhe Marcos Llorente. Vendin e parë në këtë renditje e mban Sven Botman, i cili ka një mesatare prej 39.21 kilometrash për orë, teksa ndiqet nga Darwin Nunez dhe Kylian Mbappe.

Ajaxi shkarkon trajnerin Schreuder

Ajaxi e ka shkarkuar trajnerin Alfred Schreuder. Kontrata e trajnerit ishte e vlefshme deri më 30 qershor 2024, por tani do të ndërpritet menjëherë. Pikët e shumta të humbura dhe mungesa e zhvillimit të skuadrës janë arsyt kryesore të këtij vendimi. Drejtuesit e klubit nuk kanë më besim në bashkëpunimin e mëtjetshëm. Ajaxi njoftoi se do të ndërpritet edhe bashkëpunimi me ndihmëstrajnerin Matthias Kaltenbach. Alfred Schreuder erdhi nga Club Brugge te Ajaxi verën e kaluar. Trajneri ka punuar më parë në Ajaxi si ndihmëstrajner nga janari 2018 deri në mesin e 2019-s.

Tsitsipas në finale në Australian Open

Stefanos Tsitsipas ka shënuar fitore ndaj Karen Khachanovit duke kaluar kështu në finale të Australian Openit. Greku triumfoi 3:1 në sete pas tre orësh e 21 minutash lojë, 7:6, 6:4, 6:7, 6:3. Ai në finale do ta presë fituesin e gjysmëfinales tjetër midis Tommy Paulit dhe Novak Gjakoviqit. Kjo është finalja e dytë e Tsitsipasisit pas asaj në Roland Garros më 2021 të cilën e kishte humbur nga Gjakoviqi.

Guardiola: Do t’i përgjigjesha thirrjes së Barcelonës

Trajneri i Manchester Cityt, Pep Guardiola, pranon se një thirrje nga Barcelona do ta shihte atë të kthehej në “Camp Nou”. Guardiola ka folur gjerë dhe gjatë ku njëra nga temat ishte rikthimi i Mikel Artetas tek Arsenali si trajner. Trajneri i Cityt ka thënë se e ka përkrahur rikthimin e Artetas, ashtu siç do të vepronte edhe vetë nëse Barcelona do ta thërriste të kthehej. “Arsenali ka qenë gjithmonë klubi i Artetës edhe kur ai ishte asistent këtu me mua, i vetmi ekip ndaj të cilit nuk po festonte ishte Arsenali”, ka thënë fillimisht Guardiola. “Dhe kur ai mori thirrjen nga Gunners, unë nuk mund ta ndaloja. Kush isha unë për ta bërë këtë? Më shiko, unë jam këtu, por nëse Barcelona më thërret, duhet të shkoj, sepse është klubi im”, ka përfunduar trajneri i Cityt.

Miura në moshën 56-vjeçare transferohet në Portugal

Kazuyoshi Miura nuk di të ndalet. Sulmuesi japonez, i lindur në vitin 1967, është gati të nisë një fazë të re në karrierën e tij të

jashtëzakonshme dhe shumë të gjatë. Lojtari që ka veshur fanellën e Genoas në vitet ’90 rikthehet në Evropë dhe mbërriti të enjten në Portugal

për t’iu nënshtruar ekzaminimeve mjekësore dhe për të nënshkruar kontratë deri në fund të sezonit me Oliveirense, një klub

aktualisht i 11-ti në kategorinë e dytë. Lojtari më i vjetër në botë, i cili do të mbushë 56 vjeç në shkurt, po përgatitet të fillojë një aventurë të re jashtë

Japonisë. Më parë Miura ka luajtur në Brazil, Itali, Kroaci dhe Australi. 56-vjeçari largohet nga Yokuhama FC në formën e huazimit.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government

Ministria e Punëve të Brendshme - Ministarstvo Unutrašnjih Poslova
Ministry of Internal Affairs

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë/Prishtinë
Generalna Policijska Direkcija/General Police Directorate

Departamenti për Burime Njerëzore



Në bazë të Ligjit për Policinë, kreu V, neni 44, Ligjin e Punës Nr. 03/L-212, kreu II, neni 8, Ligji për Barazi Gjinore nr. 05/L-020, neni 5 dhe 6, Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi nr. 05/L-021, neni 7, Udhëzimin Administrativ 01/2021 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, kapitulli III neni 8, neni 9 pika 1 dhe 2, dhe Vendimin e Drejtorit të Përgjithshëm datë 04.01.2023 me nr. ref: DBN 07/01/2023, Policia e Kosovës:

VAZHDON AFATIN E KONKURSIONIT

Të publikuar nga data 05.01.2023 deri me datë 26.01.2023 për pranimin e zyrtarëve policorë sipas kushteve të parapara të konkurrimit për të gjitha minoritetet (Serb, Boshnjak, Turq, Goran, Romë, Ashkali, Egjiptas, Kroat, Malazez, Maqedonas).

Titulli i vendit të punës: Zyrtar Policor
Vendi i punës : Drejtoria Rajonale e Policisë Mitrovicë Veri

Afati për paraqitjen e aplikacioneve vazhdohet për dhjetë (10) ditë duke filluar nga data **27.01.2023** deri me datë **10.02.2023**.

Vëmendje: Kriteret në konkurs mbeten të njëjta si dhe kandidatët të cilët kanë konkurruar në këtë konkurs nuk është e nevojshme të aplikojnë përsëri.

Aplikimi bëhet në formën fizike që nënkupton se aplikacioni duhet të shkarkohet nga faqja zyrtare e Policisë së Kosovës në adresën www.kosovopolic.com / Shpallje/Mundësi punësimi Aplikacioni i plotësuar së bashku me dokumentet tjera mund dërgohet fizikisht në stacionin më të afërt të Policisë ose të dërgohet përmes postës elektronike (email) në adresën: rekrutimi@KosovoPolice.com.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government

Ministria e Punëve të Brendshme - Ministarstvo Unutrašnjih Poslova
Ministry of Internal Affairs

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë/Prishtinë
Generalna Policijska Direkcija/General Police Directorate

Uprava za Ljudske Izvore



Na osnovu Zakona o Policiji, poglavlje V, član 44, Zakona o radu br. 03/L-212, poglavlje II, član 8, Zakon o ravnopravnosti polova br. 05/L-020, član 5 i 6, Zakona o zaštiti od diskriminacije Br. 05/L-021, član 7, Administrativno Uputstvo 01/2021 o Radnom Odnosu u Policiji Kosova, poglavlje III član 8, član 9, tačka 1 i 2, i Odluka Generalnog Direktora od 04.01.2023 pod referentnim br: DBN 07/01/2023, Policia Kosova:

PRODUŽENJE ROKA KONKURSA

Objavljen od 05.01.2023 do 26.01.2023 za prijem policijskih službenika po prethodnim uslovima konkursa za sve manjine (Srbe, Bošnjake, Turaka, Goranaca, Roma, Aškalije, Egipćane, Hrvate, Crnogorce, i Makedonce).

Naziv radnog mesta: Policijski službenik
Radno mesto: Regionalna Direkcija Mitrovica -Sever

Rok za prijavu aplikacija je produžen za još deset (10) dana, počevši od **27.01.2023** do **10.02.2023**.

Pažnja: Kriterijumi na konkursu ostaju isti, i kandidati koji su konkurisali na ovom konkursu ne moraju da se ponovo prijave.

Apliciranje se obavi na fizičkom obliku, što podrazumeva da se aplikacija mora preuzimati sa službenog sajta Policije Kosova na adresu www.kosovopolic.com / Oglas/Mogućnosti zapošljavanja. Popunjena aplikacija zajedno sa drugom dokumentacijom mogu se fizički proslediti na naj bliskoj Policijskoj Stanici ili da se dostave preko elektronske pošte (email) na adresu: rekrutimi@KosovoPolice.com.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



www.facebook.com/gjeipuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Ndërmarrja e Re IBG Industria e Baterive Gjilan SH.P.K. shoqëri me përgjegjësi të kufizuara me nr. Unik Identifikues 810813156 bënë shpallje në gazet për zvogëlimin e kapitalit nga 3,255,513,00 në zero.

- Hana Rexhaj shpall të pavlefshme diplomën e Fakultetit Ekonomik, të UP-së, Prishtinë.

- Burhan Gashi shpall të pavlefshme dëftesat si dhe diplomën e shkollës së mesme të mjekësisë "Dr. Ali Sokoli" Prishtinë.

- Dardan Pjetraj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e shm Mjekësisë "Hysni Zajmi" Gjakovë.

- Agron Krrakaj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e klasës së 10-të të shkollës së mesme ekonomike "Kadri Kusari", Gjakovë.

- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

- Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

ROYAL CROWN

RC

cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

RC

cola

Columbus, Georgia, USA
Since 1905

RC

cola

Columbus, Georgia, USA
Since 1905
0.5L

MEKA

HALAL FOOD

PASHTETË PULE

gluten free

100% mish pule

cilësi e garantuar

pa konservues